

Vlerësimi i procesit për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit

(Raport preliminar)



Autorë:

Instituti i Kosovës për Drejtësi

Instituti Demokratik i Kosovës

Lëvizja Fol

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e autorëve.

Korrik 2026

Prishtinë

Lista e shkurtesave

- FOL - Lëvizja FOL
- IKD - Instituti i Kosovës për Drejtësi
- KDI - Instituti Demokratik i Kosovës
- KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës
- OJQ - Organizatë Joqeveritare

Përmbajtja

1. Hyrje	5
2. Adresimi i problemeve në dizajnimin e procesit	5
3. Konfirmimi i kandidaturave.....	6
4. Hartimi i pyetjeve dhe përgatitja e intervistave	6
5. Intervistimi dhe trajtimi i kandidatëve	7
6. Poentimi i kandidatëve.....	7
7. Shpallja e rezultateve dhe transparenca publike	7
8. Vlerësimi dhe hapat e mbetur	8

1. Hyrje

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Lëvizja FOL (Tutje: Koalicioni i OJQ-ve) kanë monitoruar procesin e deritanishëm për përzgjedhjen dhe emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Ky monitorim paraqet vazhdimësi të angazhimit të organizatave të shoqërisë civile në raport me këtë proces, duke përfshirë monitorimin dhe vlerësimin e procesit paraprak, thirrjet e vazhdueshme për rishpalljen e konkursit, kontributin në procesin e ndryshimit dhe plotësimit të rregullores për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit, pjesëmarrjen në takimin për konfirmimin e kandidatave, monitorimin e hartimit të pyetjeve standarde dhe monitorimin e drejtpërdrejtë të intervistimit të pesë kandidatëve.

Bazuar në monitorimin e fazave të zhvilluara deri më tani, Koalicioni i OJQ-ve vlerëson se Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka arritur të zhvillojë një proces të rregullt, transparent, meritore dhe të barabartë ndërmjet kandidatëve. Ky vlerësim i referohet procesit të zhvilluar deri në këtë fazë, ndërsa vlerësimi përfundimtar do të varet edhe nga ligjshmëria e hapave të mbetur proceduralë.

Në procesin paraprak, Koalicioni i OJQ-ve kishte evidentuar probleme serioze në dizajnimin e procesit, strukturimin e intervistave, trajtimin e pabarabartë të kandidatëve, dyfishimin potencial të poentimit, vlerësimin e integritetit dhe mungesën e arsytimit adekuat të vlerësimit. Për këto arsye, OJQ-të kishin rekomanduar anulimin e procesit, ndryshimin e rregullores dhe zhvillimin e një procesi të ri, të strukturuar dhe të bazuar në merita.

2. Adresimi i problemeve në dizajnimin e procesit

Fillimisht, përmes ndryshimit dhe plotësimit të rregullores, KPK ka adresuar problematikat kryesore që ndërlidheshin me dizajnimin e procesit. Ndryshimet në fjalë kanë harmonizuar procedurën me legjislacionin në fuqi, kanë qartësuar kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryeprokurorit të Shtetit, kanë eliminuar paqartësitë procedurale dhe kanë zvogëluar mundësinë e vlerësimit të dyfishtë të së njëjtës aftësi apo përgjigje.

Koalicioni vlerëson pozitivisht faktin se procesi i ndryshimit të rregullores ishte transparent dhe se organizatave të shoqërisë civile iu mundësua të japin kontributin e tyre. Kjo paraqet përmirësim të rëndësishëm krahasuar me problematikat e evidentuara në procesin e vitit 2022, kur dokumentet dhe procedurat e vlerësimit ishin më shumë të orientuara drejt njohurive të përgjithshme teorike dhe nuk siguronin vlerësim të strukturuar të shkathtësive që kërkon pozita e Kryeprokurorit të Shtetit.

KPK gjithashtu ka publikuar konceptdokumentet e të gjithë kandidatëve, duke i mundësuar publikut, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile që të njihen paraprakisht me vizionin, objektivat dhe qasjen e secilit kandidat për udhëheqjen e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

3. Konfirmimi i kandidaturave

Koalicioni nuk ka evidentuar probleme përmbajtësore gjatë fazës së verifikimit dhe konfirmimit të kandidaturave. Paneli Vlerësues ka shqyrtuar dosjet e kandidatëve dhe ka konstatuar se pesë kandidatët i plotësojnë kriteret ligjore dhe rregullative për të vazhduar procesin.

Megjithatë, në fillim të kësaj faze, përfaqësuesve të organizatave monitoruese iu kërkua që të nënshkruanin një deklaratë konfidencialiteti, përmbajtja e së cilës do t'i obligonte ata që të mos raportnin për asnjë çështje që lidhej me procesin e monitorimit, nga konfirmimi i kandidaturave deri në përfundimin e procesit.

Koalicioni nuk e nënshkroi një deklaratë të tillë, duke vlerësuar se kufizimi i përgjithshëm i raportimit do ta cenonte qëllimin dhe përmbajtjen e monitorimit të pavarur. Pas kundërshtimit të organizatave monitoruese, KPK nuk insistoi në këtë kërkesë, duke mundësuar vazhdimin e monitorimit pa kufizime të tilla.

4. Hartimi i pyetjeve dhe përgatitja e intervistave

Procesi i hartimit të pyetjeve standarde është zhvilluar në prani të monitoruesve dhe është incizuar në tërësi me audio dhe video.

KPK ka ndërmarrë masa për të parandaluar daljen e pyetjeve para përfundimit të intervistimit të të gjithë kandidatëve. Në sallën ku janë zhvilluar intervistat, monitoruesit, anëtarët e Panelit Vlerësues dhe zyrtarët e Sekretariatit nuk kanë pasur në posedim telefona, pajisje elektronike apo mjete të tjera komunikimi, duke ruajtur në këtë mënyrë konfidencialitetin dhe integritetin e pyetjeve.

Anëtarët e Panelit Vlerësues fillimisht kanë propozuar një numër më të madh pyetjesh, të cilat më pas janë shqyrtuar bashkërisht. Në rastet kur pyetjet kanë trajtuar çështje të njëjta ose të ngjashme, Paneli i ka bashkuar ato ose ka përzgjedhur një të njëjtë nga pyetjet e propozuara.

Koalicioni vlerëson pozitivisht kujdesin e Panelit që pyetjet të mos përsëriteshin. Përsëritja e së njëjtës çështje përmes pyetjeve të ndryshme do të mund të rezultonte në poentim të dyfishtë të kandidatit, qoftë në mënyrë pozitive, qoftë negative, dhe do të cenonte drejtësinë e vlerësimit.

Para fillimit të intervistave, Paneli ka përcaktuar edhe atë se çfarë presin nga kandidatët në pyetjet specifike. Përcaktimi paraprak i pritshmërive dhe indikatorëve të vlerësimit është i rëndësishëm për të kufizuar subjektivitetin dhe për të siguruar që përgjigjet e të gjithë kandidatëve të vlerësohen sipas të njëjtave standarde.

5. Intervistimi dhe trajtimi i kandidatëve

Procesi i intervistimit është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe sipas orarit të përcaktuar.

Gjetja më e rëndësishme e Koalicionit të OJQ-ve është se gjatë intervistimit nuk është evidentuar trajtim i pabarabartë i kandidatëve. Të pesë kandidatët janë trajtuar sipas të njëjtave kushte dhe standarde procedurale.

Secilit kandidat i është dhënë kohë e barabartë deri në 60 minuta. Të gjithëve u janë parashtruar pyetjet e njëjta standarde dhe asnjëri kandidat nuk i janë bërë pyetje shtesë përmbajtësore. Përjashtim kanë përbërë vetëm rastet e përsëritjes ose rikujtimit të pyetjes standarde, qoftë me kërkesën e kandidatit, qoftë nga Paneli për të siguruar që kandidati ta kishte të qartë pyetjen e parashtruar.

Koalicioni nuk ka evidentuar raste në të cilat ndonjë kandidati i është ofruar kohë shtesë, mundësi shtesë për përgjigje ose ndonjë përparësi tjetër procedurale në raport me kandidatët e tjerë. Në këtë aspekt, intervistat kanë qenë të strukturuar dhe standardi i njëjtë është ruajtur gjatë gjithë procesit, duke adresuar një prej mangësive kryesore të evidentuara në procesin paraprak.

6. Poentimi i kandidatëve

Secili kandidat është vlerësuar menjëherë pas përfundimit të intervistës së tij, në prani të monitoruesve. Gjatë këtij procesi, monitoruesit nuk kanë evidentuar komunikim ndërmjet anëtarëve të Panelit Vlerësues në nivel që do të mund të krijonte dyshime për koordinim të vlerësimeve, cenim të pavarësisë së poentimit apo shkelje të konfidencialitetit të procesit.

Ndërkaq, rezultati final është publikuar pas përfundimit të të gjitha intervistave.

7. Shpallja e rezultateve dhe transparenca publike

Pas përfundimit të intervistimit dhe poentimit, rezultatet janë shpallur publikisht brenda pak minutave.

Po atë ditë, menjëherë pas procesit të intervistimit, KPK ka thirrur mbledhje të jashtëzakonshme dhe ka vendosur që intervistat e kandidatëve të publikohen dhe më pas i ka publikuar ato në platformat e saj, duke i mundësuar publikut që të ndjekë me video dhe audio performancën e secilit kandidat.

Publikimi i konceptdokumenteve, mundësimi i monitorimit të drejtpërdrejtë, incizimi i procesit të hartimit të pyetjeve, shpallja e shpejtë e rezultateve dhe publikimi i intervistave paraqesin elemente të rëndësishme të transparencës.

8. Vlerësimi dhe hapat e mbetur

Koalicioni rithekson se qëllimi i monitorimit nuk është favorizimi apo kundërshtimi i ndonjë kandidati, por vlerësimi nëse procesi siguron drejtësi, barazi, meritokraci, transparencë dhe respektim të ligjshmërisë.

Në kushtet kur këto parime janë respektuar gjatë gjithë procesit, përfshirë edhe fazën e hartimit të pyetjeve dhe intervistimit, vlerësimi i performancës së kandidatëve i takon diskrecionit profesional të anëtarëve të Panelit Vlerësues. Megjithatë, ky diskrecion nuk është i pakufizuar dhe nuk mund të shndërrohet në arbitraritet. Çdo poentim duhet të mbështetet në arsyetim konkret, të jetë në përputhje logjike me përgjigjet dhe performancën e kandidatit dhe të bazohet në kriteret e përcaktuara paraprakisht.

Koalicioni vëren se rezultatet e kandidatëve janë të përafërta. Dallimi ndërmjet kandidatit të ranguar të parin dhe kandidatit të ranguar të fundit është vetëm 5.1 pikë, ndërsa ndërmjet kandidatit të parë dhe të dytë është 2.3 pikë. Pikërisht, si arsye shtesë, për shkak të diferencave të vogla, është veçanërisht e rëndësishme që arsyetimet për poentimin të jenë të qarta, individuale, përmbajtësore dhe në përputhje me pikët e dhëna. Ndërkaq, vendimi final i takon vet KPK-s.

Koalicioni i bën thirrje Panelit Vlerësues dhe KPK-së që hapat e mbetur të zhvillohen me kujdes, duke arsyetuar qartë poentimin e secilit kandidat, duke siguruar përputhjen ndërmjet arsyetimit dhe pikëve të dhëna, duke shqyrtuar drejt dhe ligjshëm çdo ankesë dhe duke ruajtur transparencën dhe trajtimin e barabartë deri në përfundimin e plotë të procesit.

IKD, KDI dhe FOL do të vazhdojnë monitorimin e procesit deri në përfundimin e të gjitha fazave procedurale.

Pas përfundimit të procesit, Koalicioni i OJQ-ve do të publikojë një raport gjithëpërfshirës.